



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Përshëndetje të gjithëve,

Falenderoj organizatorët për ftesën për të folur në këtë takim për një çështje e cila në trajtim institucional nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është me rëndësi të dorës së parë.

Ne të gjithë e dimë që i ashtuquajtur “ligji për dekriminalizimin” ka qëllim të tij, thuajse të vetëm, ndalimin e disa individëve me të kaluar në shkelje të ligjit penal, të kërkojnë përfaqësimin e qytetarëve në Kuvendin e Shqipërisë, por edhe në funksione të tjera të larta publike.

Këtë çështje mund ta trajtojmë nga disa këndvështrime, por ajo çfarë mbetet gjithmonë e rëndësishme të thuhet është ajo se, një nga sfidat e zbatimit të këtij ligji është pikërisht parimi që sanksionon ai.

Kushtetuta dhe ligji synon ndalimin e së drejtës për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur të individëve të dënuar me burgim për vepra të rënda penale. Vetë pyetjet e parashtruara në formularin e vetë deklaramit, në të vërtetë janë një test i sinqeritetit të kandidatëve.

Në vitin 2016 kur filloi të zbatohet ky ligj, deputetët dhe funksionarët publik, gjendeshin para detyrimit të plotësonin një pyetësor që mund të sikletoste një pjesë të tyre. Të mësuar me privilegjet e të qenit në funksione të larta publike, këta funksionarë ndodheshin para dy alternativave të tregonin të vërtetën, apo ta fshihnin atë.

Jo të gjithë kishin si qëllim fshehjen e së vërtetës për t’ju shmangur penalteteve të ligjit, por kishte edhe kandidatë apo funksionarë të cilët nuk donin të kishin gjurmë të jetës së tyre ilegale.

Në këto 4 vite ligji i dekriminalizimit kompletoi ciklin e parë të zbatimit të tij deri në



nivel kapilar, duke përfshirë zgjedhjet për Kuvend dhe për organet e vetëqeverisjes vendore si dhe zëvendësimi i vakancave respektive.

Numri i kandidatëve apo funksionarëve që kanë dorëzuar formularë vetëdeklarimi përgjatë kësaj periudhe 4 vjeçare pranë KQZ-së është rreth 14,500. KQZ ka penguar zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit për 56 kandidatë dhe funksionarë publik. Gjithashtu, nuk duhen lënë jashtë vëmendjes dorëheqjet apo refuzimet për të marrë mandatet nga ana e kandidatëve, të cilët në disa raste janë imponuar nga ngurtësia e ligjit dhe në disa raste kanë qenë pjesë e taktikave lokale të kandidatëve të subjekteve politike.

Ligji i dekriminalizimit në të vërtetë i jep përgjigje dilemës nëse një individ me rekorde kriminale mund të jetë përfaqësues i popullit në një sistem demokratik. Zgjedhësit duhet të jenë të informuar për të dalluar qytetarin që shkel ligjin në dëm të jetës së personit, rendit kushtetues dhe autoritetit të shtetit. Por kjo nuk do të thotë që zgjedhësit të mos ndryshojnë pikëpamjet e tyre për përshtatshmërinë e një kandidati në një funksion publik.

Në zgjedhjet e vitit 2019, janë evidentuar përgjatë procesit të verifikimit nga ana e KQZ-së rreth 253 kandidatë të cilët nuk kanë deklaruar dënimet e mëhershme. Këta kandidatë rezultuan të dënuar apo të rehabilituar sipas të dhënave të gjendjes gjyqësore. Një pjesë e tyre janë zëvendësuar nga vetë subjektet politike përgjatë procesit të korigjimit të dokumentacionit. Pjesa më e madhe e tyre nuk janë kandidatë që kanë marrë mandatet.

Për KQZ dhe mua si Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, implementimi i këtij ligji në zgjedhjet parlamentare të datës 25 prill 2021, paraqet një sfidë të jashtëzakonshme.

Për shkak të arkitekturës së re të administratës së lartë zgjedhore, përgjegjësia për zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin e dekriminalizimit tashmë nuk është

më kolegjiale. Kjo imponon efikasitet në procesin e administrimit dhe koordinimit të verifikimeve nga njëra anë. Nga ana tjetër imponon marrjen dhe verifikimin cilësor të informacionit.

Si avokat, edhe pse jo i angazhuar në fushën penale, kam patur vëmendje për vendimmarrjet e KQZ-së në zbatimin e ligjit për dekriminalizimin, penalitetet e zbatuara ndaj funksionarëve publik apo tolerimin që iu është bërë të tjerëve.

Në këndvështrimin tim, vendimmarrja e KQZ-së për shpalljen apo mosshpalljen e pavlefshmërisë së mandatit të deputetëve/kryetarë bashkish, është shoqëruar gjithnjë me pyetjen “*dekriminalizim i politikës apo politizim i dekriminalizimit*”?

Është mëse e kuptueshme dhe e pashmangshme që për shkak të profilit të ekspozuar publik të funksionarëve këto pikëpyetje shoqërojnë çdo proces administrativ ndaj tyre. Dhe madje, do të theksoja se janë pikërisht veprimet dhe qasjet tona ndaj ligjit që formëzojnë përgjigjen ndaj çdo paqartësie.

Strategjia më e mirë për karantinimin e ndikimit të politikës nga procesi i dekriminalizimit është transparenca dhe individualizimi i tyre sipas tipologjisë së problematikës. KQZ ka siguruar transparencën më të lartë në krahasim me çdo organ tjetër të administratës publike në lidhje me procesin e verifikimit të kandidatëve. Ai i mundëson publikut të gjerë jo vetëm publikimin e formularëve të vetëdeklarimit por edhe vendimmarrjet në lidhje me rezultatet e verifikimit të tyre.

Zgjedhjet e vitit 2019, dëshmuar se tendenca e kandidatëve ishte mosdeklarimi i dënimeve/ apo problematikave të hasura nga ana e tyre me organet ligjzbatuese përgjatë jetës së tyre si brenda vendit ashtu edhe jashtë vendit.

E vërteta është se kanë qenë denoncimet e palëve të interesuara që kanë investuar organet e tjera të kryejnë verifikime të thelluara. Në këtë optikë zgjedhjet

parlamentare të 25 prillit 2021 janë një test se si efienca dhe efikasiteti i përpunimit të dhënave, do të shërbejë për denoncimin në kohë të fakteve të pa raportuara nga ana e kandidatëve.

Dëshiroj dhe shpresoj që publiku apo palët e ineteresuara të angazhohet aktivisht në denoncimin e fakteve të padeklaruara nga kandidatët. Kjo do ti shërbente KQZ-së që të marrë indicie për të dërguar sa më parë për verifikim të thelluar kandidatët e denoncuar si të pasinqertë, për të penguar në kohë marrjen e funksionit të kandidatit që nuk plotëson kushtet për tu zgjedhur funksionar publik.

Faleminderit.